



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 86, date 26.12.2017

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SË PROJEKT
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2019-2021 DHE BUXHETIT VJETOR
2019**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës 26.12.2017, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të neneve 54 shkronja "k", 55 pika 2 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 33 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, udhëzimit nr. 23, datë 22.11.2016 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012 "Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar,

V E N D O S I

1. Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së projekt programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 dhe buxhetit vjetor 2019 të Bashkisë Shkodër, sipas lidhjes nr. 1 bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miraturar në datën 26.12.2017

Shpallur në datën 27.12.2017

Sekretar i këshillit

Suel Hadri

KRYETAR

Xhemal BUSHATI

Lidhja nr.1**KALENDARI I PËRGATITJES SË PROJEKT PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2019-2021 DHE BUXHETIT VJETOR 2019**

Nr.	Struktura Përgjegjëse	Veprimi Përkatës	Periudha
1	Keshilli Bashkiak	Kalendari miratohet nga Këshilli i Bashkiak i Shkodrës	Jo më vonë se data 31 dhjetor 2017
2	Drejtoria e të Ardhurave	Pergatit raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave:	Janar 2018
3	Kryetari	Paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave	Jo më vonë se data 31 Janar 2018
4	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Nxjerr udhëzimin vjetor të përgatitjes së buxhetit vendor me treguesit makroekonomike, nivelet e transfertave dhe afatet e përgatitjes se kerkesave buxhetore	Me 28 Shkurt 2018 ¹
5	Grupi i Menaxhimit Strategjik	Pergatit dhe paraqet për miratim në këshillin bashkiak tavanet përgatitore të shpenzimeve të programeve buxhetor për periudhën afatmesme 2019-2021	Pas nxjerrjes së ushëzimit të Ministrisë së Financave,
6	Keshilli Bashkiak	Miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2019-2021	Jo më vonë se data 15 Mars 2018
7	Kryetari	Miraton udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese.	Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të taveve përgatitore nga këshilli bashkiak
8	Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor	Analizon strukturën e shpenzimeve të programeve buxhetore të bashkisë Shkodër dhe bën propozime për	Jo më vone se 10 dite nga data e miratimit te taveve nga Keshilli

¹ Ndodh qe Ministria e Financave të nxjerrë udhëzimin në fund të muajit, me 28 shkurt. Kështu Këshillit bashkiak nuk i mbetet kohe per te shqyrtuar materialin Brenda datës 15 Mars. Prandaj propozohet të planifikohet një mbledhje e këshillit bashkiak jashtë radhe.

		ndryshime.	Bashkiak
9	Ekipe e Menaxhimit të Programeve dhe Drejtoria e Analizës dhe Programit Buxhetor.	Përgatit propozimet për kërkesat buxhetore në përputhje me udhëzimin dhe tavanet e miratuara dhe ia paraqesin kryetarit të bashkisë.	Deri më 30 Prill 2018
10	Grupi i Menaxhimit Strategjik	Kryen analizat e kërkesave buxhetore, rishikon deklaratën e politikës së programeve, rishikon propozimin fillestar të kuadrit fiskal, të të ardhurave, dhe të shpërndarjes së taveve.	7 – 10 Maj 2018
11	Grupi i Menaxhimit Strategjik	Hartohet dokumenti i parë i PBA-së. Kryetari i Bashkisë i dërgon Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Projektin e Programit Buxhetor afatmesëm 2019-2021.	Deri më 1 Qershor 2018
12	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Analizon dhe përgatit një raport me mendime mbi projekt-dokumentin e programit buxhetor afatmesëm për dhe ia dërgon zyrtarisht Bashkisë Shkodër	Brenda datës 20 Qershor 2018
13	Kryetari	Paraqet në këshillin Bashkiak Projektin e parë të Programit Buxhetor afatmesëm 2019-2021.	Brenda muajit Qershor 2018
14	Këshilli Bashkiak	Këshilli Bashkiak shqyrton dhe miraton projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm duke shprehur edhe opinionin e tij mbi rekomandimet e Ministrisë së Financave.	Brenda datës 30 Qershor 2018
15	Kryetari	Publikon dokumentin e parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar nga Këshilli Bashkiak	Brenda datës 5 korrik 2018
16	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Dërgon udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit vendor në të gjitha njësitë e vetqeverisjes vendore.	Brenda datës 10 korrik 2018
17	Kryetari dhe GMS	Përgatit dhe dërgon për miratim tavanet përfundimtare në këshillin Bashkiak.	Brenda datës 15 korrik 2018

18	Këshilli Bashkiak	Miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021.	Brenda datës 20 korrik 2018
19	Kryetari	Nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të vitit 2019 të Bashkisë Shkodër dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese.	Jo më vonë se 5 ditë pas miratimit të tavanëve buxhetore përfundimtare
20	Ekipe të Menaxhimit të Programeve dhe Drejtoria e Analizës dhe Programit Buxhetor.	Përgatisin kërkesat e rishikuara buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021.	25 korrik- 15 gusht 2018
21	Grupi i Menaxhimit Strategjik	Kryen analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, dhe finalizon dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, të rishikuar.	15 -25 gusht 2018
22	Kryetari	Publikon dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, të rishikuar.	25 gusht 2018
23	Grupi i Menaxhimit Strategjik	Organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit për konsultimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021.	1-14 Shtator 2018
24	Grupi i Menaxhimit Strategjik	Sugjerimet e dëgjesave bëhen pjesë e diskutimeve në GMS në mbledhje të posaçme në përfundim të së cilave dilet me konkluzione konkrete në lidhje me sugjerimet përkatëse.	10- 14 Shtator 2018
25	Kryetari	Dergon në Ministrinë e Financave dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, të rishikuar, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave gjatë fazës së parë.	Brenda datës 15 shtator 2018

25	Ministria e Financave dhe Ekonomise	Zhvillohen seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore	brenda datës 5 Tetor 2018
26	Ministria e Financave dhe Ekonomise	Dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të programit buxhetor afatmesëm.	brenda datës 20 Tetor 2018
27	Kryetari Grupi i Menaxhimit Strategjik	Përgatit projektin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2019-2021 dhe e paraqet për shqyrtim e miratim në këshillin bashkiak, së bashku me projektbuxhetin vjetor 2019.	Jo me vone se data 30 nentor 2018
28	Këshilli Bashkiak Shkoder	Miratimi i dokumentit te projekt programit buxhetor afatmesem përfundimtar 2019-2021 dhe projekt buxhetit vjetor 2019.	Jo me vone se data 25 Dhjetor 2018
29	Kryetari	Publikimi i dokumentit te plote të programit buxhetor afatmesem 2019-2021 dhe projekt buxhetit vjetor 2019.	Jo me vone se data 31 Dhjetor 2018
30	Kryetari	Dergon në Ministrinë e Financave kopjen e buxhetit vjetor 2019.	Jo me vone se 5 dite nga data e miratimit

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI